

Raport për rezultatet e konsultimeve publike për:

Projektligjin, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 66/2023 “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”

1. Titulli i projektaktit

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 66/2023 “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Nevoja për hartimin e këtij projektligji buron nga një sërë problematikash të konstatuara gjatë zbatimit të ligjit nr. 66/2023, të cilat kanë ndikuar negativisht në administrimin, zhvillimin dhe përdorimin e objekteve të konfiskuara. Një nga çështjet kryesore ka qenë vendimmarrja e fragmentuar ndërmjet Komisionit të Objekteve të Konfiskuara, ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronave shtetërore dhe Njësive të Zbatimit. Kjo ka sjellë vonesa të konsiderueshme në administrim, amortizim të objekteve dhe mungesë efikasiteti në procesin e përdorimit të tyre.

Efektet e pritshme nga zbatimi i këtij projektligji janë krijimi i procedurave më të shpejta, më të qarta dhe më të kontrollueshme, rritja e të ardhurave nga shitja dhe përdorimi publik i objekteve, shmangia e konflikteve ndër-institucionale, forcimi i sigurisë juridike për pronarët dhe institucionet, si dhe garantimi i një niveli maksimal transparence për publikun.

Në hartimin e këtij projektakti, morën pjesë përfaqësues Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe drejtoritë përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Publikimi u bë në datë 19.12.2025 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJKP, të gjitha palët e interesuara:

- organet publike;
- shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;

- personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe
- personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë,

ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin.

Projektakti u konsultua së bashku me dokumentacionin shoqërues në RENJKP, duke qëndruar i publikuar prej datës 19/12/2025 deri në datë 21/01/2026, duke marrë 396 shikime dhe 0 komente.

Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 66/2023 “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”, është si më poshtë:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet.

3.Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese. Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Nuk rezulton të ketë patur palë të interesuara (organizata të shoqërisë civile, subjekte private apo individë), të përfshira në procesin e konsultimit publik të projekt aktit.

4. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

*Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

Nuk pati komente apo sugjerime lidhur me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 66/2023 “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”, i ndryshuar”, të publikuar në RENJK.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi	Justifikimi
(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	(grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	(Pranuar/Pranuar pjesërisht/Refuzuar)	